



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

Divizioni për Komunikim me Publikun
Divizija za Javno Komuniciranje
Division of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë 2020

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdoj të mbështes sektorin e blegtorisë përmes pagesave direkte për qumësht/litër, therrjet e raportuara të gjedhit dhe akuakulturë.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – qumësht sipas kategorive të cilësisë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të regjistruar në regjistrin e bizneseve të Kosovës (personat juridikë);
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV, numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;
- Të kenë kontratën për shitjen e qumështit me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështore të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën e grumbullimit të qumështit e cila është e regjistruara si biznes dhe ka kontratë me ndonjërin qumështore të licencuar. I pranueshëm për pagese është qumështi i kategorive: Klasa Ekstra, Klasa I-rë dhe Klasa II-të;
- Të dorëzojnë së paku 3000 litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj (sipas gjashtëmujorëve të vitit kalendarik);
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin qumështore të licencuar;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit (për persona juridikë), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruajë për kompaninë;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Kopja e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhët, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I & R) në kuadër të AUV;
- Kopja e kontratës për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose nga pikat e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjë qumështore të licencuar;
- Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikën e grumbullimit të qumështit të regjistruara si biznes dhe e cila ka kontratë me ndonjë qumështore të licencuar;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të pikës grumbulluese dhe kopja e kontratës së pikës grumbulluese me ndonjë qumështore të licencuar;
- Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të dorëzuar;
- Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit” (e lëshuar nga Projekti “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit”).

Mënyra subvencionimit:

Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në qumështore të licencuar ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjë qumështore të licencuara në Kosovë, sipas kategorive:

1. **Ekstra klasë** **0.06 €**
2. **Klasa e Parë** **0.04 €**
3. **Klasa e Dytë** **0.02 €**

Kriteret që duhet t'i plotësojnë aplikuesit/therrtoret që aplikojnë për Pagesa Direkte – therrjet e raportuara të gjedhit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të licencuara nga AUV për kategoritë të sigurisë A, B, C dhe D;
- Të raportojnë therrjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV, sipas dinamikës së paraparë të thertores;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikuara me matrikulë të Republikës së Kosovës;

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopja e certifikatës së biznesit dhe informatat e biznesit;
- Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së;

- Regjistri i kafshëve të therura, i lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit - AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së therur;
- Dëshmi – fletëpagesë dhe kuponin fiskal, me të cilët vërtetohet se është realizuar pagesa nga thertorja te fermeri, në vlerë prej **50 €/krerë** të gjedhit të therur;

Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi bëhet për krerë gjedhi të therur të raportuar, në vlerë prej **75 €/krerë**.
- Pagesës në vlerë prej **75 €/krerë** u bëhet thertoreve përfituese;
- Thertoret obligohen që vlerën e mjeteve prej **50 euro** t'ia paguajnë fermerit në momentin e therjes së gjedhit. Ndërsa vlera e mjeteve prej **25 euro** i mbetet thertores për shërbim të therjes.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – Akuakulturë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të shesin së paku **2500 kg peshk** te fresket (peshku i gjalle, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temperatur +5°C i paketuar ne vakum) brenda gjashtë (6) muajve, në Republikën e Kosovës ose jasht vendit (eksport);
- Llojet e pranueshme të peshkut janë: Trofta dhe Krapit;
- Të jenë të licencuar nga MBPZHR për zhvillimin e aktiviteteve në akuakulturë;
- Të jenë të regjistruar në AUV.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopja e certifikatës së biznesit;
- Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Certifikata veterinare - shëndetësore e lëshuar nga Praktikat Veterinare të licencuara nga AUV;
- Dëshmi për sasinë dhe vendin e origjinës së ushqimit për peshk;
- Dëshmi nga ATK, për sasinë e shitur të peshkut te fresket (peshku i gjalle, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur ne temp +5°C i paketuar në vakum).

Mënyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për kg të peshkut të shitur në vlerë prej **0.20 euro/kg**.
- Do të mbështeten (subvencionohen) të gjithë fermat - pronarët e hurdhave të peshkut që shesin së paku **2500 kg/peshk** te fresket (peshku i gjalle, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur ne temp +5°C i paketuar në vakum) brenda gjashtë muajve, në Republikën e Kosovës ose jasht vendit (eksport). Llojet e pranueshme të peshkut janë Trofta dhe Krapit.

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi,
Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore,
duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Pagesat Direkte në lëmin e Bujqësisë.

Periudha e aplikimit:

Afati i aplikimit fillon nga data 15.01.2021 dhe mbaron me datë 15.02.2021
